

FAQE 14-15

KLEDI KADIU: VAJZA E DUHUR... ? KAM SHUMË PRETENDIME

Projektet e balerinit të shquar shqiptar, që nga misioni bamirës në Banglandesh e deri tek emisionet televizive



NË BRENDESI



Faksimile e vendimit të arrestimit të Hysenil Dumes

E VËRTETA E HYSENIL DUMES, SI U SPIUNUA NGA GRUAJA E SHKRIMTARIT TË NJOHUR

Dosja e plotë/ Ja si agjencia "Shigjeta" spiunoi Hysenil Dumen dhe grupet e ashtuquajtura "Shtrigat" dhe "Krokodili". Si u shfrytëzua historia e motres së tij, martuar me një italian dhe bisedat për ushtarakët e dënuar më 1974

FAQE 17



DEBATI

Bode: Kohërat e lumit të parave kanë ikur

Fullani: Shqiptarët po konsumojnë me borxh

FAQE 6-7

OP-ED / 10,11,16



Ekonomia dhe kriza politike

Objektivi i çdo ofruesi mallrash apo shërbimesh (privat ose shtetëror) është që të plotësojë...

KOMENT EDUARD ZALOSHNIJA



Si mund ta mposhtin republikanët Obama-n

Këtë javë një koleksion republikanësh, kryesisht të...

KOMENT THE ECONOMIST



REAGIMI

Meta: Procesi kundër meje, nul dhe politik

Kreu i LSI akuzon Prokurorinë se përdori hetimin për zgjedhjet e 8 Majit "Do të luftoj për një drejtësi për qytetarin"

FAQE 9



ZBULOHET BANDA E KARTAVE TE KREDITIT, NE PRANGA EDHE NJE POLICE

Skema e vjedhjes së 30 mijë eurove dhe arrestimi i punonjësës së policisë, Rajmonda Muda, bashkëshortit të saj dhe vëllait emigrant. Vidhnin paratë e shtetasve amerikanë dhe britanikë, përmes kartave të klonuara të kreditit. Shifra e saktë e vjedhjes pritet të llogaritet pas konfirmimit nëse transaksionet bankare janë kryer ose jo. Faqe 8

Ruçi: Koalicion me LSI-në? U largua vetë! S'do jemi të ngurtë

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Gramoz Ruçi, nuk ka mohuar mundësinë e rikthimit të aleancës me Lëvizjen Socialiste për Integrim në zgjedhjet e ardhshme. I pyetur gjatë një intervistë në emisionin "5 pyetje nga Babaramo" në News 24, Ruçi tha se "nuk kemi thënë për asnjë moment që koalicioni me 22 parti nuk



Gramoz Ruçi

funksionoi, ashtu sikurse nuk kemi thënë se ky nuk do të jetë funksional sërish. Gjithashtu, nuk do të jemi të ngurtë në zgjerimin e mëtejshëm të këtij koalicioni me parti të tjera". I pyetur nëse kjo do të ndodhte edhe me LSI-në, Ruçi u shpreh se "kjo parti që ju më pyesni u largua nga koalicioni ynë për fajin e saj dhe jo për... FAQE 3

NGËRÇ NGA BUJAR KAPEXHILU



Braçe i vogël me program të madh

Për maturantët që do të vërtetohet kopjimi, do të ketë ulje pikësh në provim

Letërsia, hetim 400 testeve të dyshuara për kopjim

Procesi i shqyrtimit drejt përfundimit, së shpejti rezultatet në shkolla

Testet e të paktën 400 maturantëve që dyshohet se kanë kopjuar në provimin e parë të Maturës, Gjuhë-Letërsi, janë drejt përfundimit të shqyrtimit, dhe mbi bazën e kësaj procedure do të përcaktohen edhe penalizimet për këta nxënës. Burime zyrtare nga Ministria e Arsimit bëjnë të ditur se për provimin e Letërsisë janë 400 teste të dyshuara për kopjim, thënë ndryshe gati 10% e maturantëve. Duke qenë se provimet e këtyre maturantëve janë duke... FAQE 13



KOMENT / 11

FINANCIAL TIMES

FT

Rishikimi i Shengenit si opsion

Udhëheqësit e Bashkimit Europian pritet që të lejojnë ristrukturimin e përkohshëm të kontrollit kufitar, në rast të "situatës kritike", sa i përket emigracionit ilegal, lëvizje kjo që do e ridefinojë zonën e udhëtimit pa pasaportë brenda shteteve të Shengenit. Diplomatat e përfshirë në përgatitjen e samitit të kësaj jave të BE-së, thonë se udhëheqësit do e përkrahin idenë e anulimit të përkohshëm të mekanizmit të Shengenit, fillimisht e aplikuar në pranverë nga Italia e Franca, pasi u përballën me emigrantë të shumtë që largoheshin nga Afrika Veriore dhe e kalonin detin Mesdhe. Mirëpo, rregullat do t'i kufizojnë në mënyrë strikte rrethanat në të...




3 POLITIKË

Kutitë e dëmtuara dhe kodet shkaktojnë tension në KQZ

Përfundon numërimi i fletëve të votimit të hedhura gabim në 7 prej 11 njësjive vendore. Basha kryeson me 71 vota

Projekti

Në Festivalin Ndërkombëtar të Arkitekturës një grup arkitektësh prezantuan projektin e muzeut. Bëhet fjalë për tunelin e gjatë 650 metra dhe 12 metra të lartë, që ndodhet në pjesën veriore të Porto Palermos, ku njëherë e një kohe ankoroheshin nëndetëset tona




Tuneli në Porto Palermo, muze i Luftës së Ftohtë

Paradoksi është që janë shumë zona ushtarake, pjesa më e madhe e tyre në qytete me peizazhe të bukura, por që kjo strukturë duket shqetësuese në mes të bregdetit shqiptar. Por si mund t'i kthejmë edhe këto struktura problematike, aq më tepër kërcënuese, siç mund të jenë p.sh. bunkerët e diktaturës apo tunelet dhe zonat ushtarake, në zona turistike dhe njëkohësisht që të përshtaten me peizazhin që ofron bregdeti shqiptar. Për këtë kanë menduar një grup arkitektësh italianë, që kanë prezantuar këto ditë në Festivalin Ndërkombëtar të Arkitekturës që u zhvillua në Peruxha "Festarch 2011". Shqipëria, që në një kontekst mund t'u duket e largët (edhe pse gjeografikisht është fare pranë) italianëve Elisabeta Terragni dhe Jeffreu Schanpp, të cilët në bashkëpunim me Daniele Ledda, kanë gjetur mënyrën sesi të sjellin të shkuarën në të tashmen dhe ta përshtasin me të. Ata janë kthyer për të punuar mbi një projekt të veçantë muzeal, analog me atë që arritën të realizonin disa vite më parë në Trento, ku një tunel Luftë e kthyen në një vend turistik dhe të vizitueshëm për turistët. Për shkak të historisë së saj, çështja e përdorimit në Shqipëri i infrastrukturave të braktisura tashmë të së

kaluarës, është bërë çështje dite, madje shumë ide janë ofruar për të rivitalizuar të shkuarën tonë në të tashmen. Idesë së ngritjes së Muzeve të komunizmit i është shtuar së fundmi edhe një projekt i ri i tre arkitektëve italianë. Bëhet fjalë për tunelin e gjatë 650 metra dhe 12 metra të lartë, që ndodhet në pjesën veriore të Porto Palermos, ku njëherë e një kohe ankoroheshin nëndetëset tona, ndërsa tani mirëpret anije, jahte, apo skafe. Porta e tunelit, e tëra beton, peshon rreth 32 tonë. Pikërisht këtë tunel grupi i arkitektëve ka menduar ta kthejë në një muze, por jo në një muze të zakonshëm ku vizitori hyn dhe e vetmja gjë që i ofrohet është përshkrimi i atyre pak kilometrave tunel. Projekti ka një tjetër qëllim, atë që panorama që ofron ai vend i jashtëzakonshëm në mes të ujit dhe ajrit do të tërheqë shumë vizitore. Muzeu do të jetë një reflektim përmes dokumenteve që përcjellin ngjarjet e Luftës së Ftohtë. "Në Shqipëria ka me qindra struktura të braktisura të Luftës së Ftohtë, siç është edhe tuneli, në një zonë mjaft të bukur në jug të Shqipërisë. Ka shumë struktura të tilla që prishin në një farë mënyre panoramën, që i përkasin së kaluarës [për të cilat Ministria e

Tiranës nuk di se çfarë të bëjë. Ne me eksperiencën tonë botërore kemi nisur këtë aventurë, që është në fakt një propozim për ta kthyer këtë tunel në një muze të Luftës së Ftohtë. Një muze për të gjithë, por që nuk do të ketë karakteristikat e një muzeu të zakonshëm, por do të përshtatet me strukturën e tunelit. Do të punohet me një sistem projektionesh dhe materialesh të dala nga arkivat. Na është dashur shumë punë, në fakt. Pas suksesit që ky projekt pati në Festivalin Ndërkombëtar të Arkitekturës, do të shkojmë edhe në Tiranë për ta prezantuar atë. Parimisht është rënë dakord që kjo projekt të realizohet dhe, nëse bëhet, atëherë ai do mbyllet brenda 1 viti. Aty do të shfaqen filmime origjinale, fotografi, grafika dhe do të hapet një web për ta përfshirë edhe këtë pjesë të izoluar në perspektivën që ajo zonë ka për zhvillimin e turizmit. Më 2012 qeveria shqiptare feston 100-vjetorin e Pavarësisë dhe kërkon që me këtë rast të bëjë diçka, prandaj shpresojmë që një nga projektet që ajo do të mbështesë, të jetë edhe projekti që ne do t'i propozojmë për tunelin muze të Porto Palermos" - u shpreh ideatorja e projektit, Elisabetta Terragni. AIDA TUCI



Pamje nga projekti

Një muze për të gjithë, por që nuk do të ketë karakteristikat e një muzeu të zakonshëm, por do të përshtatet me strukturën e tunelit. Do të punohet me një sistem projektionesh dhe materialesh të dala nga arkivat. Na është dashur shumë punë, në fakt

FITUESIT E FESTIVALIT FOLKLORIK

Si isopolifonia u mirëprit nga 3 mijë spektatorë

Megjithëse kanë kaluar disa ditë kur ai është kthyer nga Klina e Kosovës, sërish mbarat ende emocionet e konkurimit në festivalin folklorik "I këndojmë lirisë". Këngëtarit popullor Nexhmin Mustafaraj është udhëheqësi artistik i grupit të këngës isopolifonike "Kurora Labe", në Gjirokastrë, grup që fitoi edhe çmimin e parë në edicionin e 11-të në festivalin folklorik të organizuar në Klinë, Kosovë. "Mendoj se krahas 28 grupeve folklorike pjesëmarrëse në këtë festival, nga gjitha trevat mbarëshqiptare, edhe grupi ynë u prezantuar mjaft mirë artistikisht, çka bëri që ai të fitonte edhe vendin e parë në festival", thotë udhëheqësi artistik i grupit

"Kurora Labe". Për të, edhe artistët popullorë nga Gjirokastra prezantuan një nivel të lartë artistik, gjatë përcjelljes te spektatorët të këngëve popullore të Shqipërisë së Jugut, ashtu si 1 mijë artistët popullorë pjesëmarrës në këtë festival, jo vetëm nga Shqipëria, por edhe Kosova, trojet shqiptare në Maqedoni, Mal të Zi etj. Grupi "Kurora labe" në festivalin folklorik të Klinës u prezantua me katër këngë isopolifonike. "Megjithëse disa herë ne kemi qenë pjesëmarrës në këtë festival, madje përpari dy vitesh kemi zënë edhe vendin e tretë, sërish emocionet kësaj here ishin të mëdha", thotë këngëtarit popullor Nexhmin Mustafaraj. "Unë, vijon ai, nuk kam për

ta harruar gjatë gjithë jetës sime mbrëmjen kur në skenën e festivalit konkurroi grupi ynë". Mes katër këngëve popullore të kënduara nga grupi "Kurora labe", spektatorët e pranishëm do të shoqëronin me duartrokitje të zjarrta këngën labe kushtuar heroit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Mujë Krasniqi. Ndërsa ne hymë në skenë dhe nisëm të këndonim në variantin isopolifonik vargjet: "O moj Klinë historilashta / të vijmë miqtë nga Gjirokastra", të 3 mijë spektatorët e pranishëm në festival u ngritën në këmbë dhe nisën të na shoqëronin me duartrokitje të zjarrta", kujton këngëtarit popullor Nexhmin Mustafaraj. BLENDAR SHEHU



"Kurora Labe", në Gjirokastrë, grup që fitoi edhe çmimin e parë në edicionin e 11-të në festivalin folklorik të organizuar në Klinë, Kosovë

